

N

JESIA ADM. LEZHË

ADMINISTRATOR : ENVER HAFIZI (PD)

TERRITORI

Sipërfaqja :5.5 km²

Koordinatat gjeografike janë : 41°49'N 19°38'E

Kjo bashki përfshin vetëm qytetin e Lezhës

DEMOGRAFIA

Popullsia (Janar 2012): 29002 banorë

Familje (Janar 2012) : 7972

Dendësia : 5273 banore/km²

Jeta urbane e Lezhës është mjaft e herëshme. Ajo fillon rreth vitit 385 para erës sonë. Herët është njohur me emrin Lissus.

Lezha është shpallur Park Arkeologjik, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 396 datë 31.03.2005.si e tillë për çdo vizitor vendas apo të huaj ajo ofron vlera unike, arkeologjike, monumentale e historike.

- Akrolissi (shek. 11 p.k.) qyteti antic mjaft i zhvilluar me rëndësi të vçantë arkeologjike dhe historike.
- Kalaja e Lezhës (fillon shek 4- përfunduar në vitin 1521) është një nga vlerat më të spikatura monumentale e historike të qytetit.
- Obelisku (ndërtuar 1968) është një vepër monumentale që përjetëson Kuvendin e Lezhës (2 Mars 1444).
- Vendvarrimi i Skënderbeut (ndërtuar 1981) është Memoriali për të nderuar vendin ku u varros Heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, (17 Janar 1468).
- Qyteti i Lezhës është vendi i harmonisë fetare e sociale.

Distanca nga Porti i Shëngjinit është vetem 6 km. Afersia me plazhet / Lezhë-Shëngjin 6 km / Lezhë-Kune rreth 8 km / Lezhë-Vain 3 km. e bëjnë më të lakmueshme.

Migrimet e viteve '90 e kanë rritur popullësinë e këtij qyteti 4 herë, duke e kthyer në një metropol Verior.